



REPUBIKA E KOSOVËS
REPUBLIC OF KOSOVO
REPUBLIKA KOSOVO

KOMUNA E KLINËS
MUNICIPALITY OF KLINA
OPŠTINA KLINA



www.komuna-kline.org

Komuna e Klinës
Kuvendi i Komunës
01Nr. 06-11655 /2026
Klinë, 27.04 /2026

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e Kuvendit të Komunës mbajtur me datë 27 Mars 2026, në orën 10:00 në sallën e Kuvendit të Komunës.

Të pranishëm në mbledhje: Kryetari I komunës së Klinës, z. Zenun Elezaj, nënkryetari I Komunës, z. Fadil Gashi, anëtarët e Kuvendit, drejtorë të drejtorive, përfaqësues të OSBE, media dhe qytetarë.

Mbledhjen e hapi kryesuesi I Kuvendit , z. Enver Berisha I cili përshëndeti gjithë të pranishmit. Për Rendin e Ditës kryesuesi hapi debat.

z. Naim Musliu: Përshëndetje. Jemi në seancën e tretë dje akoma nuk I kemi formuar komitetet obligative. Kërkoj që të futet si pikë e rendit të ditës formimi I këtyre komiteteve.

z. Valmir Bacaj: Përshëndetje të gjithëve. Kam një kërkesë të veçantë që të futet në rend të ditës. Ka të bëjë me objektin që është afër komunës , ndërhyrjes në podrumet e mbushura me kanalizime. Të I japim kompetencë kryetarit që të ndërhyjë me investime aty sepse është çështje publike gjendja e krijuar aty.

z. Enver Berisha kryesues shpjegoi se sa I përket komitetet dhe formimin e tyre ajo do të bëhet në seancën e radhës. Po ashtu kryesuesi tha se kërkesa e Valmir Bacajat është për objektin që podrumi po kundërmon dhe duhet patjetër të rregullohet. Ai e vuri në votim rendin e ditës bashkë me propozimin e Valmir Bacajt dhe **me 26 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim u MIRATUA.**

Pika 1 e Rendit të Ditës: Arsyetimi I mungesave

- Mungon për momentin vetëm Blerta Gashi

Pika 2 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi I procesverbalit nga ,mbledhja e kaluar

- **Me 26 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim u MIRATUA**

Pika 3 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi I rekomandimeve të KPF-së

U propozua që të votohet në pako me përjashtim propozimin e banorëve të objektit “Benita”

Për këtë pikë kryesuesi tha se duhen të dhëna të tjera shtesë për këtë propozim dhe propozoj që për këtë çështje të autorizohet kryetari që bashkë me banorë dhe akterë të tjerë relevant ta shqyrtojnë.

z. Naim Musliu: Sa I përket këtij propozimi ne jemi pro por duhet ta kemi parasysh se mund të bëhet precedent për të ardhmen. Kemi objekte siç është ai I OVL që nuk ka ashensor dhe jemi dëshmitar që një person që ka banuar aty e ka lënë banesën dhe ka dalë të jetoj diku tjetër shkaku I gjendjes shëndetësore dhe mos mundësisë së ngjitjes së shkallëve.

z. Fadil Gashi, nënkryetar: Nuk është precedent sepse edhe objekti I OVL edhe dy objekte të tjera tek “Rafi” në mandatin e kaluar kanë filluar që të instalohen ashensorët. Pra është projekt që po vazhdohet.

z. Tunë Dedaj: Përshëndetje të gjithëve. E përkrahu këtë iniciativë por kam kërkesë edhe nga qytetarët për banesën ku e ka ndërtuar z. Desku ku dy ashensor nuk punojnë e po ashtu edhe banesa përballë “Albinut”. Jam që të ju ndihmohet qytetarëve dhe të gjitha ata banorë që mbledhin 30% të mjeteve të tjerat të I financoj Komuna.

z. Kushtrim Haliti: Përshëndetje. Ne nuk mund të instalojmë ashensor nëpër banesa private që kanë ndërtuar njerëzit. Edhe unë kam ndërtuar një objekt dhe kërkoj që të më instalohet ashensori. Ndërsa tek Banesa “Benita” është mirë të intervenohet sepse aty përveç tjerash është bërë edhe e rrezikshme për banorët fasada e rënë.

z. Tunë Dedaj: Kushtrim unë e diji se çfarë po kërkoj. Nuk kërkoja për ndërtesa private. Objekti tel Alba market ka qenë shtetërore përpara por ne duhet të ju dalim ndihmë banorëve.

Kryesuesi propozoj që edhe këtë çështje të vihet në përgjegjësinë e kryetarit të Komunës dhe e vuri në votim propozimin

Me 25 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA.

Në vazhdim të shqyrtimit të rekomandimeve të KPF-së kryesuesi shpалosi dy kërkesa të cilat propozoj që të adresohen në zyrën e kryetarit dhe për këtë propozim kërkoj që të votohet.

Me 27 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Kërkesë tjetër nga KPF ishte edhe ajo për vendosjen e disa krojeve në qyte. Një prej tyre tek familja Dushi, aty ku dikur ka qenë një burim uji I pijshëm si dhe një tek memoriali I personave të pagjetur të luftës. Kryesuesi propozoi që të deklarohen anëtarët e kuvendit për këtë çështje dhe e vendosi ne votim.

Me 27 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Kërkesa tjetër ishte nga OVL për dhurimin e një veture nga ana e Komunës. Kryesuesi tha se bashkë me kryetarin e kanë biseduar këtë çështje dhe bordi I komunës e ka aprovuar. Kryesuesi tha se janë të gjitha të dhënat e veturës dhe ajo është e gatshme për t'ju dhuruar OVL të UÇK-së.

Me 27 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 4 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi I propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake nga viti 2025 në vitin 2026.

Kryesuesi tha se anëtarët e kanë marrë një material më të ri që është një ndryshim dhe kërkoi nga drejtori që të prezantoi.

z. Faruk Smajli, drejtor I FEZH: Përshëndetje të gjithëve. Duke u bazuar në ligjin për ndarjen buxhetore. Kërkojmë bartjen e mjeteve të pa shpenzuara nga 2025 dhe mjetet e tejkalimit të planit për vitin 2025, në vitin 2026.

Drejtori shpjegoi në detaje se për cilat mjete bëhet fjalë dhe përmendi shumat përkatëse. Ai tregoi edhe detyrimi për rialokim të mjeteve pas marrjes së mjeteve nga përmbaruesi për shkaqe të vendimeve të gjykatave.

z. Valmir Bacaj: Ne e kemi dhënë qëndrimin tonë edhe në KPF, këto mjete janë në funksion të realizimit të investimeve kapitale prandaj ne jemi dakord.

Kryesuesi tha se në të ardhmen ndoshta do të jemi të obliguar që të bëjmë harmonizime shtesë shkaku se përmbaruesi I ka marrë mbi një milion euro.

Me 27 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 5 e rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi I propozimit nga drejtorja e kulturës për ndarjen e mjeteve buxhetore për festivalin folklorik "I këndojmë lirisë"

Vlera e mjeteve që duhet të ndahen është 30 mijë euro.

z. Kushtrim Haliti: Jemi për ndarjen e mjeteve por kërkojmë që pasi të përfundoi festivali të na sjellët një raport që ta dimë se nga po shkojnë mjetet pasi që ka biznese që po ankohen se ju kanë mbet borgj.

Kryesuesi, z. Berisha tha se festivali I ka përgjegjësit e vet, dhe është I sigurt që do të na e sjellin raportin e shpenzimeve.

z. Asdren Ramadani: Përshëndetje të gjithëve. Dëshiroj të pyes se a është paraparë se sa do të jetë shuma për finalistin e, vendin e parë. Ajo shumë të jetë më e lartë se sa vendi I dytë apo I tretë. Po jepen 30 mijë euro dhe në fund vendit të parë po I ndahen vetëm 1000 euro.

Kryesuesi I kuvendit tha se ndoshta nuk ka asgjë të keqe që edhe ne si asamble të I rekomandojmë udhëheqësit të festivalit që vlera për vendin e parë të dallohet.

Me 27 vota për asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 6 e rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi I propozimit për ndërrimit të titullarit për pronat e BVI në pronësi të komunës

z. Nikson Dakaj, drejtor I kadastrit: Përshëndetje. Duke marrë parasysh interesin publik të realizimit të projekteve, pronat në fjalë janë të regjistruara në emër të BVI prandaj shpeshherë paraqiten pengesa në realizimin e projekteve. Për ti shmangur këto pengesa është e domosdoshme që të ndërrohet titullari nga BVI në pronësi të Komunës së Klinës.

z. Naim Musliu: Dëshiroi të pyes nëse është planifikuar të investohen në këto prona? Ne gjithsesi do ta votojmë këtë kalim pasi që është në interes të komunës.

z. Nikson Dakaj, drejtor I kadastrit: Po ka projekte të planifikuara e një ndër ta është edhe impianti I ujit ku është ndërtuar. Ka po ashtu edhe shkolla të regjistruara në emër të titullarit që nuk ekziston më, dhe është e nevojshme që të kalohet në pronë komunale.

Me 25 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 7 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi I propozimit për ndërtimit të sheshit të qytetit të Klinës

z. Enver Berisha, drejtor I urbanizimit: Përshëndetje. Do të jua prezantoj në pika të shkurta idenë, projektin që e kemi. Bashkë me mua është edhe stafi. Ideja e komunës për rregullimin e sheshit është ardhur nga kërkesat e qytetarëve të Klinës. Ne bashkërisht me inxhinierët e Komunës dhe stafin e kontraktuar për projektet zbatuese kemi ardhur në përfundim dhe kemi nxjerr një model të pranueshëm që do të jua prezantoj juve përmes slajdëve.

Drejtori prezantoj përmes tabelës së mençur projektin vizual duke thënë sheshi nuk do të ndërrohet për shkak të identitetit të tij dhe mund të mirëmbahet më lehtë pasi që ka pak hapësirë. Në përgjithësi mendohet të hiqen kabëzat nga rruga dhe të shtrohet shtresë asfalti e ku do të shtohet gjelbërimi dhe elemente të tjera sigurie et. Qëllimi është që të evitohet pluhuri, balta dhe të ulët kosto e mirëmbajtjes. Punimet do të jenë në dy faza tha drejtori. Faza e parë do të organizohet një ankand publik që do të bëjë heqjen dhe shitjen e kalldrëmit dhe faza e dytë ekzekutimi I projektit. Nuk do të preket galeria e brendshme dhe as brezi në mes dhe shtegu i ecjes. Mendojmë që është ide dhe vizion që duhet përkrahur nga ju tha drejtori Berisha në fund të prezantimit të tij.

z. Ndrec Zefaj: Përshëndetje. E dëgjova me vëmendje ekspozenë e paraqitur. Së pari kam një vërejtje për ekzekutivin sepse këtë projekt kanë pasur mundësi të na dërgojnë përmes emailit në mënyrë që ne si anëtarë të kuvendit të kemi mundësi ta analizojmë më mirë. Megjithatë duke e pas parasysh kërkesën e madhe të qytetarëve që në këtë shesh të ketë ndërhyrje, siç dihet ky shesh ka një kohë të gjatë që ka problem si gropa dhe kundërmime të kanalizimeve, dua të paraqes disa propozime: vendosja e ulëseve modern në secilën pjesë të sheshit, të ketë gjelbërim shumë më shumë dhe të jetë dekorativ, të ndryshohet gjitha ndriçimi që është aktualisht. Të vendosen llamba modern siç janë në sheshin e komunës se Pejës, Gjakovës. Të vendosen shporta të mbeturinave të dizajnuara. Në kuadër të këtij projekti propozoj që të futen edhe prijtoret për qytetarët për autobusë, këto prijtores të vendosen në katër hyrjet e qytetit. Kërkoj që për këtë projekt të rëndësishëm të mos jetë ndërhyrje sipërfaqësore por serioze.

z. Kushtrim Haliti: Janë disa kundërthënie me atë që e tha drejtori. Ai tha që do të I heqin kubëzat dhe do të shtroj me granit. Pse nuk e ka sjellë komplet projektin se si do të dukej. Apo do ta bëjnë sikurse rrugën e Gjimnazit ku tjetër gjë ka qenë në projekt dhe tjetër gjë në realitet. Sa I përket arsyes se pluhuri po ju shkon nëpër shtëpia., s` di si ka me ju shkuar nëpër shtëpia kur ky shesh është me kubëza. Normal qe prishet rruga sepse nuk po kujdesen me ujin I cili tërë ditën rrjedh nëpër rrugë. Nuk na e tregoi koston drejtori, duhet ta dimë edhe ne se çfarë po votojmë, sa është kosto e këtij projekti. Për mendimin tim projekti është gjysmë dhe nuk është I mirë. Është I pa kompletuar.

Z. Enver Berisha, drejtor I urbanizimit: Ju tregoj se gjelbërimi do të jetë I shtuar, pastaj ndriçimi I cili është aktual është I mirë pasi që nuk e pengon gjelbërimin. Kosto është prezantuar dhe është diku 400-450 mijë euro. Nuk do të ndryshon krejt sheshi por vetëm rruga. Nga 9500 metra katrorë do të nderohen vetëm 5000 metra katrorë. Nëse dëshirojmë që ta prezantojmë pikë për pikë do të na duhen disa orë.

z. Ndrec Zefaj: Sa I përket ndriçimit, shumë në rregull është por ju ftoj që të dilni jashtë Kline dhe të shikoni edhe sheshe të tjera. Ideja është që të rregullohet njëherë e mos të ndërhyhet çdo vit në shesh.

Znj. Jehona Gashi: Përshëndetje. Sa I përket sheshit, është shume e nevojshme ndërhyrja por kam një propozim. Meqenëse nuk jam eksperte e kësaj fushe, mendoj që duhet të konsultoheni me ekspertë dhe sheshin ta rregulloni me gurë të Gllarevës pasi që janë shumë cilësor. Në këtë mënyrë mund ta simbolizojmë qytetin me diçka tonën. Pengesat e menduara që do të vendosen mendoj që janë të dëmshme pasi që në këtë shesh kalojnë edhe autoambulancat.

z. Kushtrim Haliti: Drejtorin dëshiroj ta pyes se a kanë lënë diku parking për veturat që ndalojnë 5 minuta për nevojat emergjente.

Z. Enver Berisha, drejtor I urbanizimit: E nderuara Jehona. Ne e kemi parë se si është të ndërtohet rruga me gurë. Nuk ndryshon pjesa e brendshme e rrugës por vetëm rruga dhe Kushtrim, nuk mund të krijojmë xhepa parkingu që ja prish estetikën e sheshit.

Znj. Teuta Mulaj: Rindërtimi I rrugës është mese I nevojshme por kam një propozim. Ne jemi përfaqësues të qytetarëve dhe këtu sjellim kërkesat dhe mendimet e qytetarëve prandaj kërkoj që kjo çështje të kaloj në dëgjim publik. Ne e dimë që rrugët me kalldrëm janë të qëndrueshme por në këtë rast nuk është kryer një punë e mire dhe po I vuajmë pasojat. Dua ta dijë se sa ka me qenë I qëndrueshëm ky shesh I rindërtuar. Në KPF kemi kërkuar që të kemi një ekspert të kësaj fushe që të na tregoj qëndrueshmërinë e këtij sheshi me qellim që të sjellim kualitet të mirë për qytetarët dhe të kursehet intervenimet e shpeshta pasi që ka shumë punë të tjera që duhet kryer.

Znj. Mendehie Duraku: Përshëndetje. Sa I përket çështjes së rregullimit të sheshit pajtohem që kemi obligim që të jua lehtësojmë vështirësitë qytetarëve. Megjithëkëtë, kjo çështje kërkon një trajtim më të kujdesshëm dhe profesional. Në shumë qytete të Kosovës kemi parë që kubëzat kur vendosen në rregull dhe mirëmbahen janë shumë më të qëndrueshme. Prandaj është e arsyeshme të vlerësojmë pse kemi ardhur në këtë gjendje, qoftë për shkak të punimeve jo të mira apo mos mirëmbajtjes. Në një të ardhme të afërt pritet që të përfundojnë edhe rrugët transit që do ta

lehtësojnë komunikacionin brenda qytetit. Qyteti ynë meriton zgjedhje cilësore, të qëndrueshme dhe afatgjate dhe jo vetëm zgjidhje të shpejt.

z. Naim Musliu: Të dashur kolegë e qytetarë të Klinës. Sot po diskutojmë një çështje goxha sensitive. Për sheshin e Klinës dhe të ardhmen e tij. Sheshi është një hapësirë [publike Brenda qytetit ku është e destinuar për aktivitet publik. Kur pushteti lokal në Klinë me planifikimin buxhetor të vitit 20015, 2016, 2017, planifikonte ndërtimin e galerisë dhe shtrimin me kubëza që është një nga projektet më të mira të ndërtuara ndonjëherë e kishte për qëllim ndërtimin e një hapësirë në shërbim të komunitetit. Në vitin 2017 ju erdhët në pushtet ku punimet e këtij sheshi ende nuk kishin përfunduar. Fatkeqësisht ju hapësirën e destinuar për shesh e shëmtuat duke vendosur disa KUNJA përgjatë gjithë sheshit. Qytetarët janë lodhur nga gropat në shesh por një gjë duhet ta dinë të gjithë. Nuk është problem sheshi si koncept por mos mirëmbajtja e sheshit ashtu siç duhet. Prej ndërtimit të këtij sheshi e deri me sot asnjëherë në shesh nuk janë bërë ndërhyrje profesionale për sajimin e gjendjes. Sa herë është ndërhyrë është bërë edhe më keq se sa ka qenë sepse jo gjithë punëtorët mund të merren me këtë punë specifike. Dikush me të drejt mund të pyes e thotë se gjatë ndërtimit nuk janë kryer punimet siç duhet, ndoshta ka të drejt por nëse është e vërtetë komuna nuk është dashtë të bëjë pranim teknik. Është dashtë ta detyroj kompaninë që të kryej punimet sipas standardeve. Nëse është bërë pranimi teknik I këtij projekti me punimet e kryera jo mirë, dikush duhet të marrë përgjegjësi. Ideja e drejtorit që të I heq kubëzat dhe bëjë asfalt paraqet një shkurtpamësi. Është ide e ngutshme e dëmshme dhe besa edhe e rrezikshme. Besoj fuqishëm që përfaqësuesit e qytetarëve që jemi ne nuk do të lejojnë kthim të Klinës nga një qytet urban në një qendër transit për kalimin e banorëve të komunave të tjera. Problemet që kemi sot në shesh janë përgjegjësi e juaja, sepse ju I keni shikuar punimet dhe nuk e keni mirëmbajtur sheshin. Ne duhet parë alternativa dhe sheshin ta bëjmë tamam shesh e jo rrugë me asfalt.

z. Musliu vazhdoi tutje me fjalimin e tij duke kundërshtuar shtrimin me asfalt të sheshit duke dhënë edhe ide se si do të ishte më mirë që të rregullohet sheshi. Duke e përfunduar fjalimin e tij ai tha se në historinë e shesheve të qyteteve , sheshet janë në interes të qytetarëve, nuk qarkullohet me makina. Qytetet I kanë bllokuar këto qarkullime , çdo qytet e ka sheshin e vet, qyteti pa shesh është pa zemër, ku mungon galeria dhe funksionaliteti I tij siç do të duhej. Ai bëri thirrje që ta kundërshtojmë idenë e heqjes së kubëzave , kërkoj që të intervenohet profesionalisht në rregullimin e tij dhe të mendohet për gjeneratat e ardhshme.

Znj. Jehona Gashi: Mendoj që edhe ne si opozitë edhe ju si pozitë mendoni për të mirën e qytetarëve. Në fakt ne asfalt e kemi provuar, edhe me kubëza e kemi provuar, të merret ideja e shtrimit me gurë të Gllarevës. Këto ide duhet të I shqyrtojnë profesionistet pasi që as unë e as ju nuk jeni ekspert.

Kryesuesi tha se sa I përket profesionistëve kemi këtu dy profesionist.

z. Enver Berisha, drejtor I urbanizimit: Kemi dy ekspert tanë këtu dhe nuk është mirë me na fyer. Po ashtu jemi konsultuar edhe me kompaninë e projekteve. Sa I përket atyre që I tha Naimi nuk do të I marrë për bazë fare sepse janë fjalime të thata. Dua të kursehem e të mos flas për këtë shesh. Është nisur ndryshe dhe ka përfunduar ndryshe ju lutem kursemëni që mos të flas.

z. Naim Musliu: Nëse ty të duken të thata e filozofike fjalët e mija drejtor, qytetarët do ta vlerësojnë. Se sa ja donë të mirën qytetarëve ti e ke treguar me fabrikën e çimentos. Unë kërkova raport , a ke raport teknik kur thua se sheshi nuk I plotëson kriteret minimale për të qenë shesh.

z. Enver Berisha, drejtor I urbanizmit: Disa herë thash se ne kemi kërkuar nga operatori që kemi të kontraktuar për projekte zbatuese që të na bëjë një analizë dhe ai e ka bërë. Kur të duash ti dërgojmë më shkrim.

Znj. Marigona Racaj: Përshëndetje. Sa I përket projektit të sheshit mendoj që duhet marrë një vendim afatgjatë e jo të përkohshëm. Kubëzat janë dëmtuar vërtet dhe po krijojnë problem. Vendimet tona duhet të jenë praktike dhe ekonomike e në interes të qytetarëve.

Znj. Marqe Selmanaj: përshëndetje. Duke e marrë parasysh gjithë këtë debat nuk mund të I thuash asnjëherë anë se nuk ka të drejtë. Nuk është menduar që në këtë shesh të kalojnë veturat. Sikur të ishte shesh nuk do të kalonin automjetet dhe ne do të ishim krenar për këtë shesh. Sheshi me këto kubëza të jep imazhin e një qyteti të bukur por që duhet të merren masa dhe të ndryshohet. Mendoj që kur është projektuar ky projekt nuk ka ekzistuar edhe buxhetimi gjinor. Shpeshherë me organizata të ndryshme e kemi biseduar buxhetimin gjinor dhe nuk është paraparë ecja për zonjat me taka. E dëgjova drejtori që tha se gurët do të shiten por pse ata gurë të mos shërbejnë për ndërtimin e pushimoreve nëpër fshatra, kënde të lojërave etj. Ato kubëza do të ishin të mirë kudo që të investoheshin. Unë propozoj që të kemi një kënd të bukur, pushimore të bukur që është premtuar me kohë në Zllakuqan.

z. Valmir Bacaj: Sa I përket sheshit të Klinës, është e domosdoshme ndërhyrja në këtë shesh. Secila ndërhyrje në këta gurë veçse e ka vështirësuar dhe s' ka pasur efekt. Ky nuk është shesh në fakt, është rrugë. Në sheshe nuk kalohet me vetura. Destinimi I këtij sheshi është që të kalohet me vetura dhe shtrimi me kubëza në këtë rast nuk preferohet. Unë e kuptoj tendencën e PDK-së që të I epet peshë investimit që kanë bërë por ne duhet të jemi të sinqertë me qytetarët: Ka qenë vendim I gabuar, investim I gabuar që të shtrohet me kubëza. Është dashtë të planifikohet më mirë nëse kanë dashtë të mendohet për shesh e jo të ndërtohen objekte shumëkatëshe në shesh. Tani nuk mund të mendohet për shesh. Kubëzat krijojnë shumë problem dhe vështirësi, janë pastruar vazhdimisht por ka qenë e kotë. Të merret me seriozitet ky projekt sepse është bërë nga ekspert të fushës dhe jemi me vonesë. Projekti është fenomenal, ne jemi përfaqësues të popullit dhe duhet të marrim vendim. Kryetari ka qenë I interesuar që të marrim një vendim unifikues. Kryetari do ta prezantoj një sondazh për këtë projekt edhe ne facebook.

z. Tunë Dedaj: Unë kam qenë anëtar I kuvendit në kohën kur është miratuar projekti I këtij sheshi. Projekti ka qenë shumë I mirë dhe jam prej atyre që e kam votuar atë projekt. Por, ai projekt nuk është zbatuar mirë dhe ka qenë I gabuar. Një të mirë të vetme është se na e ka lënë galerinë. Nuk e kam pas plan që të votoj që të hiqen këto kubëza por kërkesa e qytetarëve që të hiqen kubëzat dhe të kthehet në asfalt. Po ashtu shtegu I biçikletave të hiqet dhe të mendohet për gjininë femërore dhe të merret parasysh staza për to.

z. Fadil Gashi, nënkryetar I Komunës: Ne kemi qenë pjesë kur është miratuar projekti në këtë kuvend, dhe po e them atë që e kam thënë në atë kohë. Të gjithë që keni fëmijë, nipa e mbesa, dilni me karrocë dhe e shihni se si I tundë fëmijët në karrocë. Në mandatin e kaluar e kemi debatuar

këtë çështje dhe nuk patëm mirëkuptim duke kërkuar sikurse po kërkoj sot për të gjithë që mos të I epim ngjyrë politike. Ne prezantuar anën profesionale të projektit, këtë nuk e ka bërë as unë as Kryetari por profesionistët. Nganjëherë po rrëshqasim dhe po diskutojmë punën e profesionistëve. Emërtimi shesh, nuk është ky që ne po e shohim. Nëse është zënë sheshi është zënë me objekte të larta. Që të ruhet sheshi nuk është dashur që të ndërtohen objekte të larta. Pra ne po prezantojmë diçka që është imediate. Deri sot nuk kam takuar qytetar që ka thënë se ky shesh është mirë, të gjithë që thonë se është bërë I padurueshëm. Në KPF u tha se qytetarët po na japin vërejtje duke thënë se ky shesh është bërë I padurueshëm dhe unë po them që nuk po na japin vërejtje por po na shajnë që nuk po ndërhyjmë. Ne nuk mund të mbesim peng as I Sokol Bashotës as I Zenun Elezit, kjo nuk po bëhet për inati të dikujt e as nga hatri I dikujt. Duhet të zhvishemi nga këto inercione dhe t'ju japim qytetarëve atë që duan për ta shfrytëzuar. Nuk ka nevojë që të merret bajraku as nga ata që e kanë ndërtuar këtë shesh e as nga të tjerët që do ta bëjnë tani. Vetëm që ta dini se prej që është ndërtuar ky shesh neve po na futet uji në podrume të banesave, ata që jetojnë këtu e dinë. Pra edhe një herë, është bërë një prezantim I projektit që ka me na hyj në punë të gjithëve. Bëhet fjalë për 7 metra rrugë, projekt I bërë nga profesionistët që sipas tyre ka dalë që shtrimi me asfalt është më I pranueshëm për momentin sepse të ardhmes nuk I dihet. Unë ju bëj ftesë që mos të ndaheni në votime. Qysh ka të drejt dikush të thotë që mos të preket sheshi ashtu ka të drejt tjetri të thotë që të shtrohet asfalti, nuk ka pronësi individuale. Le të bashkohemi rreth këtij projekti të gjithë.

Znj. Teuta Mulaj: Nuk e morra përgjigjen e qëndrueshmërisë së asfaltit që do ta kemi. Dua të dijë se çfarë do të votoj. Për qëndrueshmëri jemi duke e ndryshuar këtë shesh prandaj dua ta dijë unë dhe qytetarët që po na ndjekin.

z. Enver Berisha, drejtor I urbanizimit: Ndoshta na ka ikur ai element por ju them se minimum qëndrueshmëria e tij do të jetë 5 herë më I madh se sa kubëzat aktuale.

z. Arben Limanaj: Në KPF, unë bëra një pyetje për ekipin që ka hartuar projektin se a do të prishën kubëzat tek sheshi sepse e dimë që nuk kemi kompani që po dinë të shtrojnë si duhet kubëza. Tjetër çfarë dëshiroi të kërkoj nga ekspertët është tek pjesa e sheshit “Ibrahim Rugova” të cilin shesh e kemi votuar por nuk po punohet asgjë në këtë drejtim. Kërkoj nga ekspertët që të ndërhyhet në këtë projekt dhe të përfshihet edhe sheshi “Ibrahim Rugova”. Po ashtu propozimet e dhëna nga Ndrec Zefaj, të dimë se a mund të përfshihen. Përndryshe edhe unë pajtohem që të ndërhyhet sepse është bërë e nevojshme.

Në lidhje me këtë temë u inkuadruan edhe z. Esat Raci, nënkryetari I cili informoi se shtatorja e Ibrahim Rugovës do të vendoset në sheshin me të njëjtin emër me datë 2 korrik, etj. Në fund u vendos në votim dhe

Me 17 vota për, 8 kundër, dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 8 e Rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi I propozimit për themelimin e KKSB

Për këtë pikë referoj znj. Marqe Selmani dhe në fund u MIRATUA propozimi me 20 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim

Pika 9 e Rendit të Ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit për emërimin e delegatëve për kuvendin e AKK

U propozuan:

1. Marqe Selmani
2. Naim Musliu
3. Enver Berisha, kryesues I kuvendit

Me 21 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA

Pika 10 e Rendit të Ditës: Rishqyrtimi I vendimit 01Nr.06-3646/2026 për iniciimin e procedurës për ndryshimin dhe plotësimin të hartave zonale të komunës së Klinës.

Pas prezantimit të drejtorit të urbanizimit të ndryshimeve dhe plotësimeve të kërkuara, në debat morri pjesë edhe z. Tunë Dedaj dhe z. Naim Musliu. **Në fund të debatit me 19 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

Pika 11 e rendit të Ditës: Dhënia e kompetencave kryetarit të Komunës për ndërhyrje investive në podrumin e ndërtesës në krahë të komunës, rregullimin e tij.

Pas fjalës së kryetarit të komunës I cili shpjegoi rëndësinë e ndërhyrjes në këtë pjesë të kësaj ndërtese, kryesuesi I kuvendit e vendosi në votim dhe **me 20 vota për, asnjë kundër dhe asnjë abstenim U MIRATUA**

Pika 12 e rendit të Ditës: Pyetje dhe përgjigje

Në këtë pikë me pyetjet e tyre u angazhuan z. Kushtrim Haliti me pyetje për drejtorin e shërbimeve publike, z. Qendrim Millaku I cili dha përgjigjen, pastaj kësaj ju bashkëngjiti edhe kryetari I komunës, z. Zenun Elezaj duke e plotësua. Pyetje tjetër kishte nga znj. Jehona Gashi për drejtorin Millaku ku gjithashtu mori përgjigje edhe nga drejtori por edhe nga kryetari I komunës. Pyetjeve të z. Naim Musliu, znj. Marqe Selmani, z. Arben Limanajt, z. Ndrec Zefajt, z. Jeton Gashit, z. Faton Berishës, dhe z. Tunë Dedajt, ju përgjigjen drejtorët: z. Enver Berisha, drejtor I urbanizimit, z. Qendrim Millaku, drejtor I Shërbimeve publike, z. Binak Sylaj, drejtor I administratës, si dhe kryetari I komunës, z. Zenun Elezaj.

Në fund të kësaj pike seancën e shpalli të mbyllur kryesuesi, z. Enver Berisha duke falënderuar të gjithë për angazhimin dhe kontributin e dhënë.

Procesmbajtës:
Skënder Behramaj



Kryesues:
Enver Berisha